

Gjendja e zbatimit të Programit Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës

CPC, dhjetor 2014

RRPP Dialogu për politika – Analizë 2/2014

Hyrje

Në maj të vitit 2013, Qendra për Kurajo Politike (CPC) botoi raportin e titulluar „[Ndikimi i politikëbërësve në punën kërkimore-shkencore në Kosovë](#)”. Gjetjet e këtij raporti u nxorën nga diskutimet në tryezën e rumbullakët me aktorët e përfshirë në politikën e arsimit të lartë në Kosovë, si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i Kuvendit të Kosovës. Një nga gjetjet kryesore ishte se Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Programi për Shkencën) është zbatuar vetëm pjesërisht.

Kjo analizë mëton të shqyrtojë gjendjen aktuale të zbatimit të Programit për Shkencën. Me qëllim të hulumtimit të kësaj çështjeje, u zhvilluan disa intervista dhe diskutime joformale me Drejtorin e Departamentit për Shkencë dhe Teknologji të MASHT-it, koordinatorët e projekteve kërkimore-shkencore të përfutësve individual a institucional të granteve, si dhe hulumtuesit e angazhuar në institutet kërkimore.

Gjetjet e kësaj analize do të përdoren si mjet për të promovuar¹ zbatimin më gjithëpërfshirës të Programit për Shkencën.

Programi për Shkencën

Strategjia evropiane 2020 ka për qëllim të mbështes rritjen ekonomike, të kontribuojë në zvogëlimin e varfërisë dhe të krijojë kushtet për një treg pune më konkurrues dhe punësim. Në mënyrë që të arrihen këto synime deri në vitin 2020, strategjia ndjek tre prioritete që duhet të jenë thelbi i strategjisë Evropa 2020: rritjen e „mençur”; rritjen e qëndrueshme; dhe rritjen gjithëpërfshirëse.² Ndonëse ka mjaft dëshmi se shkenca, puna kërkimore dhe inovacioni kontribuojnë dhe përshpejtojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe hartimin e politikave bazuar në të dhëna, përmirësimi i kapaciteteve në Kosovë deri më tani nuk është përcaktuar si një synim real dhe vendi është shumë larg përmbushjes së prioriteteve të strategjisë Evropa 2020. Në të vërtetë, në 25 vitet e fundit nuk ka pasur ndonjë investim serioz në shkencë, punë kërkimore dhe teknologji në Kosovë.

¹Në prill të vitit 2013, CPC themeloi një grup punues të përbërë nga përfaqësues të MASHT, zyrës së Rektoratit të UP, profesorë nga Departamenti i Shkencës Politike, Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti Juridik dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të kontribuar dhe avokuar për avancimin e kapaciteteve kërkimore.

² „Tre prioritetet duhet të jenë në thelb të strategjisë Evropa 2020: rritja e mençur – zhvillimi i ekonomisë në bazë të dijes dhe inovacionit; rritja e qëndrueshme – promovimi i një ekonomie më efektive në përdorimin e burimeve, të gjelbër dhe konkurruese; rritja gjithëpërfshirëse – nxitja e ekonomisë me punësim të lartë e që rezulton në kohezion ekonomik, social dhe territorial”. Shih „Evropa 2020: një strategji për rritje të mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse”, Komisioni Evropian, Bruksel, 3 mars 2010, f. 10. Në dispozicion në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF> (qasur më 29 tetor 2014).

Në përputhje me Ligjin nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, në mars të vitit 2010 Këshilli Kombëtar i Shkencës miratoi Programin për Shkencë. Ky dokument i politikave synon identifikimin e prioriteteve kërkimore, fuqizimin e pjesëmarrjes së Kosovës në programet shkencore ndërkombëtare dhe investimin në infrastrukturën gjegjëse.³ Për më tepër, Programi Kombëtar i Shkencës përvijon pengesat që frenuan punën kërkimore dhe shkencore në Kosovë gjatë viteve 1990-ta, të tilla si mungesa e zhvillimit ekonomik dhe përjashtimi i botës akademike nga arena shkencore ndërkombëtare. Prandaj qëllimi afatgjatë i Programit Kombëtar të Shkencës është që të „neutralizojë këto deficite duke ofruar një kornizë konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë”.⁴ Megjithatë, mangësia kryesore sistematike në këtë aspekt është mungesa e mjeteve financiare për të përkrahur veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe ndërtimin e kapaciteteve, të cilat janë planifikuar në kuadër të Programit për Shkencën. Përafërsisht vetëm 0.1% e Bruto Produktit Vendor (BPV) të Kosovës ndahet për punë kërkimore-shkencore dhe zhvillim, shumë më ulët se mesatarja në rajon, Evropë e më gjerë⁵, siç edhe paraqitet në dy tabelat e mëposhtme.

Shteti	Shqipëri	Bosnje dhe Hercegovinë	Kroaci	Kosovë	Maqedoni	Mal i Zi	Serbi	Sllloveni
Shpenzimet në % të BPV-së për Kërkim dhe Zhvillim (K&ZH)	0.15	0.02	0.75	0.1 ⁶	0.23	0.41	0.73	2.51

Shteti	Austri	Belgjikë	Republika Çeke	Danimarkë	Finlandë	Izrael	Japoni	Republika e Koresë
Shpenzimet në % të BPV-së për (K&ZH)	2.75	2.04	1.84	3.09	3.78	4.39	3.26	3.73

Burimi: të dhënat janë nxjerrë nga Treguesit e Zhvillimit Botëror: shkencë dhe teknologji (*World Development Indicators: Science and technology*).⁷

Ndonëse përqindja e BPV që Kosova e ka ndarë për punë kërkimore dhe zhvillim është njëra ndër më të ulëtat në krahasim me vendet e tjera, mjetet e plota financiare të parapara nuk janë

³ Shih „Ndikimi i politikëbërësve në punën kërkimore-shkencore në Kosovë”, maj 2013. Në dispozicion në: [http://cpc-ks.org/repository/docs/Briefing_paper_Policymaker_Impact_on_Research_Work_in_Kosovo_\(Albanian\)_420484.pdf](http://cpc-ks.org/repository/docs/Briefing_paper_Policymaker_Impact_on_Research_Work_in_Kosovo_(Albanian)_420484.pdf) (qasur më 2 nëntor 2014).

⁴ Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, janar 2010, f. 15.

⁵ Në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 04-L/135 për veprimtari kërkimore shkencore që përcakton se „[p]ër sigurimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme për veprimtarinë kërkimore shkencore, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan zero pikë shtatë për qind (0.7%) të buxhetit vjetor vendor.” Në dispozicion në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20veprimtari%20kerkimore%20shkencorel.pdf> (qasur më 19 nëntor 2014). Sidoqoftë këto mjete ose nuk janë ndarë, ose janë ndarë në shuma simbolike siç edhe paraqitet në tabelat në këtë analizë.

⁶ Ndonëse Kosova përmendet në raportin e Bankës Botërore, të dhënat për shpenzimet për punën kërkimore dhe zhvillim nuk janë cekur. Shih „Banka Botërore 2014, Shtetet dhe Tregjet, 5.13 Treguesit e Zhvillimit Botëror: shkencë dhe teknologji”. Në dispozicion në: <http://wdi.worldbank.org/table/5.13> (qasur më 31 tetor 2014).

⁷ Shih „Banka Botërore 2014, Shtetet dhe Tregjet, 5.13 Treguesit e Zhvillimit Botëror: shkencë dhe teknologji”. Në dispozicion në: <http://wdi.worldbank.org/table/5.13> (qasur më 31 tetor 2014).

ndarë as deri më sot. Në vend të € 5,393,953 milion të planifikuara për financimin e 22 veprimtarive që lidhen me punën kërkimore, shkencën, infrastrukturën, mobilitetin, ndërkombëtarizimin e punës kërkimore-shkencore, themelimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë, vetëm € 580,000 janë ndarë për jetësimin e Programit për Shkencën. Ndonëse deri në vitin 2015 planifikohet themelimi i së paku 10 laboratorëve, secili prej tyre vlerësohet se do të kushtojë më shumë se € 250,000, buxheti i përgjithshëm prej € 580,000 do të ishte i mjaftueshëm për të blerë 2 laboratorë, duke lënë anash të gjitha veprimtaritë e tjera të Programit për Shkencën. Programi për Shkencën parasheh shpenzimeve vjetore nga € 4.5 milion deri në € 6.5 milion për zbatimin e veprimtarive të planifikuara, qoftë në programet e mobilitetit, „kthimin e trurit”, botimet, qasjen në bibliotekat elektronike, mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të instituteve kërkimore, pjesëmarrjen në projektet ndërkombëtare, etj. Megjithatë, ky buxhet nuk është ndarë as për komunitetin akademik as për institutet kërkimore.

Me qëllim të krijimit të „Shoqërisë së Dijes në Kosovë”, siç thuhet në moton e MASHT-it, Programi për Shkencën përcakton pesë objektiva dhe masa që do të arrihen deri në vitin 2020:

1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore-shkencore;
2. Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore;
3. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore;
4. Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social;
5. Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore.⁸

Deri më sot asnjë nga veprimtaritë e planifikuara në kuadër të Programit për shkencën nuk është zbatuar në tërësi. Tabela në vijim paraqet objektivat dhe veprimtaritë e Programit për Shkencën ku edhe analizohet gjendja e zbatimit të tyre.

⁸ Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, janar 2010, f. 5.

Objektivat:	Veprimtaritë ⁹	Gjendja e zbatimit ¹⁰
1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore-shkencore	- Deri në vitin 2015 të paktën 50 kandidatë do të marrin mbështetje për të ndjekur studimet e pasdoktoratës nëpërmjet programeve të përbashkëta me financim të plotë ose të pjesshëm nga Buxheti i Kosovës.□	- Deri në vitin 2014 asnjë kandidat nuk ka marrë mbështetje të plotë apo të pjesshme nga Buxheti i Kosovës për të ndjekur studimet e pasdoktoratës. Ata kandidatë të cilët kanë ndjekur studimet e tyre të pasdoktoratës deri më tani janë mbështetur nga Projekti HigherKos.
	- Deri në vitin 2015 të paktën 100 kandidatë nga Kosova të cilët ndjekin studimet e doktoratës në ndonjë nga 500 universitetet më të mira të botës do të marrin mbështetje të plotë ose të pjesshme nga Buxheti i Kosovës.□	- Deri në vitin 2014, nga 138 kandidatë nga Kosova të cilët ndjekin studimet e doktoratës në ndonjë nga 500 universitetet më të mira në botë, vetëm 58 janë përkrahur nga Buxheti i Kosovës.
	- 100 bursa afatshkurtra mobiliteti të përcaktuara për hulumtuesit aktivë.	- Në vitin 2012, 30; në vitin 2013, 38 dhe në vitin 2014, 42 bursa mobiliteti iu ndanë hulumtuesve.
2. Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore	- Deri në vitin 2015, do të bëhet themelimi i të paktën 10 laboratorëve (secili me vlerë € 250,000) plus ndarja e pajisjeve shkencore në një shumë totale prej € 1 milion.	- Deri në vitin 2014 asnjë laboratorë nuk është themeluar me mbështetjen e plotë apo të pjesshme nga Buxheti i Kosovës. 20 laboratorë janë themeluar dhe pajisur nga programet e TEMPUS.
	- Deri në vitin 2012 ndërtohet sistemi informativ i Kërkimeve dhe Zhvillimit Teknologjik (KZHT).	- Deri në vitin 2014, sistemi informativ i KZHT nuk është themeluar ende.
	- Deri në vitin 2011 sigurohet qasja në bibliotekat elektronike relevante.	- Deri në vitin 2012 universiteteve publike në Kosovë iu sigurova qasja në ISI Web of Knowledge (ISI rrjeti i dijes). MASHT ka parapaguar qasjen në koleksionin e EBSCO, por shumica e hulumtuesve nuk kanë pasur njohuri për këtë shërbim.
3. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore	- Mbështetje për botimin e një numri të konsiderueshëm të publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare.	- Deri në vitin 2014, MASHT ka mbështetur 8 hulumtues për botimin e publikimeve në revista ndërkombëtare.

⁹ Objektivat dhe veprimtaritë burojnë nga Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, janar 2010, f. 16-19.

¹⁰ Intervistë me Murteza Osdautaj, Drejtor i Departamentit për Shkencë dhe Teknologji (MASHT), 22 shtator 2014.

	<p>- Vlera e përgjithshme vjetore e projekteve të përbashkëta kërkimore me institucionet e huaja është të paktën € 2 milion duke filluar me vitin 2012.</p>	<p>- Deri në vitin 2014, MASHT ka ofruar mbështetje për 51 projekte të vogla (me vlerë nga € 10,000 deri në € 40,000). Fituesit e bursave janë të obliguar që të bashkëpunojnë me hulumtuesit ndërkombëtarë.</p>
	<p>- Pjesëmarrje e zgjeruar në rrjetet ndërkombëtare hulumtuese.</p>	<p>- Deri në vitin 2014, MASHT ka botuar 75 monografi shkencore.</p> <p>- Deri në vitin 2014, MASHT ka mbështetur tre revista shkencore në Kosovë.</p> <p>- Deri në vitin 2014, asnjë informatë nuk është siguruar për vlerën vjetore për projektet e përbashkëta kërkimore me institucionet e huaja.</p> <p>- Deri në vitin 2014, Kosova ka vendosur partneritet me katër projekte ndërkombëtare dhe disa nisma rajonale të tilla si Strategjia për Evropën Juglindore 2020.</p>
	<p>- Bashkëpunim i përmirësuar me studiuesit me origjinë kosovare që punojnë jashtë.</p>	<p>- Deri në vitin 2014, nuk ka pasur bashkëpunim të rëndësishëm me hulumtuesit kosovarë të cilët punojnë jashtë.</p>
4. Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social	<p>- Krijimi i një programi të zbatueshëm të KTZH-së për të mbështetur raportet shkencë-industri.</p>	<p>- Deri në vitin 2014, MASHT nuk ka krijuar programin e zbatueshëm të KTZH-së për të mbështetur raportet shkencë-industri.</p>
	<p>- Krijimi i një programi për inovacione për të përmbushur nevojat e inovacionit ekonomik dhe social të sektorit privat (biznesit, OJQ) deri në vitin 2015.</p>	<p>- MASHT ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Inovacion, por deri në vitin 2014 ajo ende nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës.</p>
5. Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore	<p>- Themelimi i qendrave të përsosmërisë shkencore.</p>	<p>- Deri në vitin 2014 nuk janë themeluar qendrat e përsosmërisë shkencore.</p>
	<p>- Themelimi i fondit për çmime për arritje të jashtëzakonshme.</p>	<p>- MASHT ka krijuar çmimin Shkencëtar i Vitit dhe çmimin Shkencëtar i Ri i Vitit.</p>
	<p>- Zhvillimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë në fushën e kërkimit shkencor, si doracakëve për indeksimin e botimeve.</p>	<p>- Deri në vitin 2014 nuk janë themeluar mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të instituteve kërkimore.</p>

Kriteret e vlerësimit, kufizimet dhe rezultatet e projekteve kërkimore-shkencore të financuara nga MASHT

Programi për Shkencën përcakton 5 kriteret për vlerësimin e projekteve kërkimore-shkencore, që mëtojnë të kontribuojnë në zbatimin e objektivave të përgjithshme. Këto kriteret të përgjithshme janë:

1. Rëndësia për zhvillimin e Kosovës;
2. Vlera shkencore dhe përmasat ndërkombëtare të projektit;
3. Arritjet shkencore të bartësit të projektit;
4. Kompetenca e organizatës aplikuese;
5. Përshtatshmëria ekologjike e projektit.¹¹

Në periudhën 2013 – 2014, MASHT mbështeti 22 të ashtuquajtura projekte të vogla kërkimore-shkencore. Nga këto, 4 janë në fushën e mjekësisë, 2 janë ndërdisiplinore, 2 përqendroheshin në bujqësi, 5 në mjedis, 2 në histori dhe 7 prej tyre janë projekte kërkimore-shkencore në fushën e ekonomisë dhe shkencave shoqërore. Për periudhën 2014 – 2015, MASHT ka mbështetur 9 projekte kërkimore-shkencore, ndër të cilat 2 janë ndërdisiplinore, 1 përqendrohet në gjuhë, kulturë dhe histori, 2 në bujqësi, 2 në mjekësi, 1 në mjedis dhe 1 në ekonomi.

Ekzistojnë tre faza të vlerësimit të projekteve kërkimore-shkencore që dorëzohen në MASHT. Në fazën e parë, Departamenti për Shkencë dhe Teknologji vlerëson aspektet teknike të projekt propozimeve kërkimore-shkencore. Pas pranimin nga ana e Departamentit në fjalë, propozimet kërkimore-shkencore dorëzohen në Këshillin Shkencor të MASHT që i jep rekomandimet përfundimtare Ministrisë të MASHT, duke vlerësuar nëse projektet përputhen me objektivat strategjike të Programit të Shkencës. Sidoqoftë, çështja kryesore përkitazi me procesin e vlerësimit është se ai nuk është i mbështetur në kriteret shkencore, por në afërsinë politike të aplikantit të projektit. Për shembull, disa hulumtues kosovarë nënvizojnë atë se shumë përfitues të granteve të vogla janë të lidhur me partinë politike të Ministrisë.¹²

Numri i projekteve kërkimore-shkencore dhe buxheti i siguruar nga MASHT ngel i kufizuar, si edhe kapacitetet kërkimore dhe numri i aplikimeve për mbështetjen kërkimore-shkencore. Në përgjithësi, megjithatë, procedurat e aplikimit për të ashtuquajturat grante të vogla nuk janë të ndërlikuara. Sidoqoftë, vetëm disa hulumtues ia dalin që të botojnë në revistat ndërkombëtare që ekzaminohen nga ekspertë, ndërsa të tjerët nuk kanë shfaqur interes për të thithur fondet dhe për të realizuar projekte kërkimore-shkencore. Një nga pengesat për të zhvilluar punë kërkimore-shkencore në Kosovë është mungesa e të dhënave të sakta, të tilla si qasja në bibliotekat elektronike gjë që ua vështirëson punën hulumtuesve për të pasur qasje në burimet e përditësuara.

„Ndikimi i masave të drejtësisë tranzicionale në ndërtimin e shtetit demokratik në Kosovë” është titulli i një prej projekteve kërkimore-shkencore të financuara nga MASHT. Mungesa e mobilitetit dhe mundësitë e kufizuara për të shfrytëzuar bibliotekat ndërkombëtare janë cekur si

¹¹ Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, janar 2010, f. 8.

¹² Intervista dhe diskutime jozyrtare me hulumtues kosovarë, Prishtinë, tetor 2014.

dy pengesa kyçe gjatë kryerjes së këtij projekti kërkimor-shkencor. Projekti morri vetëm € 4,600 nga buxheti i kërkuar prej € 12,000, prandaj veprimtaritë e propozuara si vizitimi i bibliotekave jashtë vendit dhe botimi i katër punimeve kërkimore-shkencore, u lanë mënjanë.¹³ Një projekt tjetër kërkimor-shkencor i financuar nga MASHT në vitin 2013 titullohej „Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Zonën Operative të Shalës”.¹⁴ Projekti kërkimor-shkencor me titull „Formimi i identitetit profesional të mësimitdhënësve” ka nënvizuar se motivimi i mësimitdhënësve të ardhshëm dhe përkushtimi i tyre ndaj profesionit të mësimitdhënësit siguron potencialin për zhvillimin e identitetit profesional. Një metodë e studimit induktiv u përdor për të analizuar pikëpamjet e ndryshme për mësimitdhënien dhe motivimin për profesionin e mësimitdhënësve. Studimi u krye në Fakultetin e Edukimit me 761 mësimitdhënës të ardhshëm dhe 10 fokus grupe. Rezultatet e projektit kërkimor-shkencor sugjerojnë se MASHT duhet të zgjerojë perspektivën e mësimitdhënësve të ardhshëm, përmes programeve për arsimimin e mësimitdhënësve. Rezultatet e projektit kërkimor-shkencor janë dorëzuar për botim në një revistë shkencore, si dhe do të paraqiten në një konferencë ndërkombëtare.¹⁵

Megjithatë një numër i konsiderueshëm i koordinatorëve të projekteve kërkimore-shkencore, të cilët u intervistuan, nuk mund të shpjegojnë se si është shpenzuar përkrahja financiare e MASHT-it dhe se cili është rezultati i tyre konkret kërkimor-shkencor. Kjo na çon në konstatimin se, përveç nevojës evidente për më shumë mbështetje financiare dhe sistematike për veprimtarinë kërkimore-shkencore, mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe një shkallë më e lartë e transparencës dhe profesionalizimit duket që janë thelbësor për zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë.

Rekomandimet:

Për Qeverinë e Kosovës

- Të bëjë inovacionin, punën kërkimore-shkencore dhe zhvillimin një nga prioritet kyçe të politikave;
- Të rris në masë të konsiderueshme përqindjen e BPV së Kosovës që investohet në projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillim.

Për MASHT

- Të zbatojë në tërësi Programin për Shkencën dhe të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për veprimtaritë e planifikuara;
- Të emërojë përsëri Këshillin Kombëtar të Shkencës si organ kryesor për Strategjinë Kombëtare të Shkencës së Republikës së Kosovës;

¹³ Intervistë me fituesin e mbështetjes nga MASHT Remzije Istrefi, profesoreshë në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2 tetor 2014.

¹⁴ Intervistë me fituesin e mbështetjes nga MASHT Sabit Sylja, Drejtor i Institutit të Historisë „Ali Hadri”, Prishtinë, 9 tetor 2014.

¹⁵ Intervistë me fituesin e mbështetjes nga MASHT Eda Vula, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 13 tetor 2014.

- Të zhvillojë fushata të rregullta njoftimi për mundësitë e financimit për projektet kërkimore-shkencore;
- Të sigurojë informata për procedurat e aplikimit dhe formularët për projekte kërkimore-shkencore në të tria gjuhët: në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;
- Të ndajë fonde për punë kërkimore-shkencore në bazë të kriterëve profesionale dhe shkencore, si dhe të fuqizojë komisionet profesionale të vlerësimit dhe të përjashtojë ndërhyrjen politike;
- Të përmirësojë procedurat e raportimit dhe monitorimit nga përfituesit e granteve që jepen nga MASHT për veprimtari kërkimore-shkencore;
- Të sigurojë qasjen në bibliotekat digjitale akademike për të përmirësuar cilësinë e punës kërkimore-shkencore në Kosovë dhe të mundësojë qasjen në burimet e përditësuar akademike;
- Të sigurojë se rezultatet e projekteve kërkimore-shkencore, të cilat mbështeten nga MASHT, postohen në ueb faqe dhe i shpërndahen komunitetit akademik dhe politikëbërësve.

Për përfituesit e granteve:

- Të përmirësojnë kapacitetet e thithjes së fondeve dhe shkathtësitë për hartimin e projekteve;
- Të themelojnë, në kuadër të instituteve të tyre kërkimore, mekanizmat e sigurimit të cilësisë;
- Të bashkëpunojnë me institutet kërkimore ndërkombëtare dhe të sigurojnë komente dhe ekzaminime nga ekspertët për produktet e tyre kërkimore-shkencore;
- Të botojnë rezultatet në revistat ndërkombëtare që egzaminohen nga ekspertë dhe të prezantojnë rezultatet e studimeve të tyre për politikëbërësit kosovarë;
- Të angazhohen më shumë në projekte kërkimore ndërdisiplinore midis fushave të ndryshme që ceken në Programin Kombëtar të Shkencës.

Programi për Promovim të Hulumtimeve Rajonale (RRPP) udhëhiqet nga Universiteti i Friburgut me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), Departamentit Federal për Punë të Jashtme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e SDC apo të Universitetit të Friburgut.